

ABDURRAHIM MAXHUNI

KONTRIBUTI I STUDIUESVE TË HUAJ NË FUSHËN E ALBANOLOGJISË NË REVISTAT SHKENCORE NË KOSOVË

811.18(091)

Abstrakt: Shqipja vazhdimesht ka qenë objekt studimi nga studiues të huaj. Kujtojmë se Frac Bopi ishte studiues i parë që përcaktoi karakterin indoевropian të gjuhës shqipe. Kontributi i autorëve të huaj nuk ka munguar asnjëherë. Rezultatet e hulumtimeve të tyre i kanë paraqitur në forma e mënyra të ndryshme. Një nga këto ka qenë dhe vazhdon të jetë përmes prezantimit të tyre në revista shkencore, apo në periodikun shkencor, fillet e së cilës në Kosovë i kemi pas Luftës së Dytë Botërore, përkatësisht në vitin 1946 me nxjerrjen e revistës “Përparimi”. Më pas më 1962, Fakulteti Filozofik në Prishtinë, nxori revistën “Gjurmime Albanologjike”, e cila nga viti 1970 ka kaluar në pronësi të Institutit Albanologjik në Prishtinë. Pastaj, më 1965 del revista “Buletini”, më 1972 revista “Kosova”, ndërsa revista “Studime” në kuadër të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës fillon të dalë më 1994. Duke qenë të rëndësishme për veprimtarinë shkencore, publikimi i rezultateve të autorëve të huaj është shumë i rëndësishëm. Në këtë kumtesë do të vështrojmë kontributin e tyre në revistën “Studime” dhe revistën “Gjurmime albanologjike- seria e shkencave filologjike”, të fushës së albanologjisë.

Fjalët kyçë: revista shkencore, autorë të huaj, albanologji.

Abstract: The contribution of the foreign scholars in the field of Albanology in the scientific magazines in Kosova

Albanian Language has constantly been a subject of study for foreign scholars. We remember Frac Bop as the first scholar who determined the indo-european character of the Albanian Language. The contribution of foreign authors has never been absent. Their research results were presented in different manners. The scientific magazines were and are still one of the means to present for the public their research results, such as in the scientific Periodical Magazine, which was started after the Second World War; it was exactly the year 1946 that this Periodical Magazine “Përparimi” started to be published.

Then in 1962, the Philosophical Faculty in Prishtina published the magazine “Gjurmime Albanologjike” (Albanological research); this magazine continued to be published by the Albanological Institute from 1970. In 1965 we also witnessed the publishing of the magazine “Buletini”, in 1972 the magazine “Kosova”, whereas in 1994 the Academy of Sciences and Arts of Kosova started publishing the magazine “Studime”. We consider publication of the scientific research results of the foreign authors as a very important element for the scientific activity. In this paper we will be able to see their contribution in some of these magazines, in the field of Albanology.

Key words: scientific magazines, foreign authors, Albanology.

Revista “Studime”¹

Kjo revistë është organ i Akademisë së Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. Numri i parë doli më 1994 në Prishtinë. Në këtë revistë shkencore deri në numrin 21 i kemi 28 shkrime të autorëve të huaj. Në këtë revistë janë botuar artikuj të autorëve sllovenë, russë gjermanë, francezë, amerikanë etj. Ndër kontribuuesit më të mëdhenj janë: E. P. Hamp, Marko Snoj, Victor Friedman, Christain Gut, Robert Elsie, Michael

¹ Këtë revistë e kemi shikuar deri në numrin 29.

Caxner, Agnja Desnickaja, Joachim Matzinger, Armin Hetzer, Basil Schader, Franc Kriznar, Brain D. Joseph. Vlen të përmendet se disa nga shkrimet e këtyre autorëve janë përkthime të redaksisë.

Ndër studiuesit e huaj që kanë kontribuar në rrafshin gjuhësor në këtë revistë kemi autorin Eric P. Hemp. Në numrin dy të kësaj reviste, autori në fjalë paraqet artikullin e tij “Shënime për relikte procesesh të shkuara morfologjike”¹. Në këtë qasje morfologjike autori merret me analizën e hollësishme të elementeve nën vështrimin në nivelin Indoevropian, duke këmbëngulur veçanërisht në analizën e aspektit morfologjik. Kështu, ai merret me sqarime që qartësojnë kontekstin dhe rrugën e zhvillimit të *shaj* dhe elementeve të afërtë, pastaj me *vajzë*, *pe* dhe *karpë/karmë*, duke propozuar etimologjinë me shumë shpjegime strukturale.

Po në këtë numër, kemi një autor nga Lubjana e Sllovenisë Marko Snjo², i cili merret me studimet albanistike në slloveni. Në këtë studim, ashtu siç edhe mund të vërehet nga titulli, autori merret me data, regjistrimin dhe vëzhgimin e interesimit për studimet e gjuhës shqipe në Slloveni, që nga fillimi deri në fillimet e viteve të 90-ta të shekullit të kaluar. Ai ka prezantuar punën e autorëve të mirënjohur, si Jernej Kopitar dhe Franc Miklošić, por edhe të Rajko Nahtigalit, Ivan Koshtial, Karel Oshtir, si dhe ndihmesën e autorëve shqiptarë në njojhen e gjuhës shqipe në Slloveni.

Në këtë numër paraqitet edhe amerikani tjetër, po nga Çikago Viktor Friedman³ me “Mbi rindërtimin e situatës dialektore shqipe dhe sllave në mesin e shekullit XIX në Traki”.

Në këtë artikull autori i diskuton faktet e dialektit bullgar, të regjistruar jo shumë moti, të cilat ai mundohet t'i definojë nga Trakia turke në bazë të dëshmitarëve të jashtëm dhe të brendshëm, ndoshta të fshatit Pomak. Ky dialekt u dëshmuia në një dokument të shekullit XIX, i cili lidhet me bullgarishten dhe shqipen. Ai ka të bëjë me fjalorin bullgarisht-shqip të 1864 që i përket dorëshkrimi të paraqitur në Manastirin Hilndar në malin Atos. Autori në fjalë në numrin 4, publikon edhe artikullin “Mbi konceptet nacionale në fjalorin tri gjuhësh të Gjorgji Pulevskit”.⁴

Në numrin 4 të kësaj reviste kemi edhe artikullin e Kristian Gutit⁵ nga Parisi i cili ka të bëjë me një tekst shkodran të pabotuar të vitit 1850. Autori i këtij artikulli merret me studimin e aspekteve gjuhësore të ndryshme të një dorëshkrimi të panjohur të shekullit XIX, me originë nga Shkodra, dorëshkrimi i cili paraqet interes të vërtetë si dëshmi e të folmes së Shkodrës së asaj kohe. Edhe pse nuk pasqyron të gjitha veçoritë e kësaj të folmeje, ky tekst ka vlera dialektologjike. Në fakt, ky është një tekst i klerit shkodran, i lexuar në kishë kundër aktivitetit të çiftit, njëri prej të cilëve ishte figurë e njojur e kulturës shqiptare dhe lëvizjeve politike, Vaso Pasha, i cili dyshohej se ishte martuar me gruan e tij të dytë para vdekjes së burrit të saj të parë.

Robert Elsie⁶ paraqet artikullin mbi leksikun shqip të Evlija Çelebiut i vitit 1662 dhe ç'duhet të dijë dervishi shtegtar. Sipas autorit Evlija Çelebiu ishte shkrimtar me imagjinatë dhe burim i pashtershëm informatash për jetën e përditshme të Shqipërisë së shekullit XVII. Fjalorthi i tij i shqipes i hartuar gjatë qëndrimit në Shkodër më 1662 që ofron çka duhet të dijë një dervish derisa udhëton në tokat e të pabesëve për pjesën më të madhe është shënuar me saktësi dhe mund të përdoret edhe sot me ndonjë sukses nga udhëtarët e huaj. Megjithatë, autori rekomandon kujdes dhe rezerva.

¹ Eric P. Hamp, *Shënime për relikte procesesh të shkuara morfologjike*, në “Studime”, nr. 2, Prishtinë, 1995, f. 191-200.

² Marko Snjo, *Studime albanistike në Slloveni*, në “Studime”, nr. 2, Prishtinë, 1995, f. 201-210.

³ Victor Friedman, *Mbi rindërtimin e situatës dialektore shqipe dhe sllave në mesin e shekullit XIX në Traki*, në “Studime”, nr. 2, Prishtinë, 1995, f. 211-224.

⁴ Victor Friedman, *Mbi konceptet nacionale në fjalorin tri gjuhësh të Gjorgji Pulevskit*, në: “Studime”, nr. 4, Prishtinë, 1997, f. 123-129.

⁵ Christain Gut, *Një tekst shkodran i pabotuar i viteve 1850*, në: revistën “Studime”, nr. 4, Prishtinë, 1997, f.147-157.

⁶ Robert Elsie, Olzheim, *Leksiku shqip i Evlija Çelebiut i vitit 1662 dhe ç'duhet të dijë dervishi shtegtar*, në: revistën “Studime”, nr. 4, Prishtinë, 1997, f.239-249.

Në numrin 5,6,7 kemi një artikull të Majkëll Daksner¹ me titull një peizazh shkencor evropian, i cili e përshkruan punën e Akademisë dhe bashkëpunimin e tij me këtë Akademi.

Më tutje po në këtë numër kemi artikullin mbi prejardhjen e gjuhës shqipe, të studiueses nga Rusia, Agnja Desnickaja.² Në këtë artikull, çështjes së origjinës së shqipes i qaset nga aspektet historiko-krahasimtare dhe historiko-shoqërore. Që të mund të diskutojë për origjinën e gjuhës shqipe, ajo fillon me katër ndarjet e saj të historisë së gjuhës shqipe: periudha protoshqipe, periudha e shqipes së lashtë, periudha e shqipes së mesme dhe periudha e shqipes moderne.

Viktor Fridman³ përsëri paraqitet me artikullin pas 170 vjetësh gjuhësi ballkanike: në fund të mileniumit? Pas konstatimit të përgjithshëm të autorit se studimet gjuhësore ballkanike duan parë nga aspekti i kontekstit të jashtëm, i përkufizimit të disiplinës së studimit dhe nga aspekti i diskutimeve midis atyre që janë marrë me këto çështje, ai nxjerr përfundimin se është e nevojshme që në fillim të mijëvjeçarit të ri të reflektohet për të kaluarën e disiplinës.

Më tutje kemi artikullin e Brain Josef⁴ nga Universiteti shtetëror i Ohajos. Këtu ai shqyrton rolet e dyanshme të arbërishtes brenda Greqisë si gjuhë minoritare dhe në raport me shqipen e folur në Shqipëri. Në numrat 8-9 kemi artikullin e Viktor Fridmanit⁵ Metoda me mbështetje gramatikore drejt kompetencës për shqipen dhe disa vërejtje për mësimdhënien e gjuhëve më pak të mësuara të Evropës lindore.

Në numrat 8-9 kemi edhe artikullin e Armin Hetzer⁶, Krijimi i shqipes kombëtare. Autori përshkruan procesin e gjatë të zhvillimit të letërsisë dhe të gjuhës së njësuar shqipe në sfondin e të dhënavë socio-kulturore, duke vënë në dukje kontributin e përfaqësuesve të elitës së vendit deri te Lufta e Dytë Botërore. Rrihen çështje të analfabetizmit, të arsimit si dhe të shkollimit të lexuesve.

Kristian Gut⁷, rrok edhe njëherë temën e mëparshme për tekstin e pabotuar shkodran të viteve 1850, duke e publikuar tekstin i cili për shkaqe teknike nuk ka dalë.

Në numrin 10 të kësaj reviste kemi artikullin Pashko Vasa dhe vepra e tij nga Kristian Gyt⁸.

Po në këtë numër kemi artikullin e Erik Hempit⁹, Studies in indo-evropean *oi, ei.

Në numrin 11 botohet artikulli i Basil Schaderit¹⁰ Hulumtime gjuhësore rrëth kod-suiçingut shqip-gjermanisht në Zvicrën gjermanofolëse. Po në këtë numër Franc Krashnar¹¹ nga Sllovenia boton artikullin Mjetet dhe gjuha shprehëse komposicionale-teknike në opusin e kompozitorit Zeqirija Ballata. Vilfred Fidler¹² në numrin 12 boton artikullin Zgjedhimi i katërt dhe gjuha e Buzukut. Po në këtë numër Kristina Gyt¹³, boton artikullin Pashko Vasa dhe Alfabeti.

Eric Hamp¹, në numrin 13 të kësaj reviste boton artikullin Vendi i shqipes.

¹ Michael Caxner, *Një peizazh shkencor evropian*, në: revistën “Studime”, nr. 5,6,7, Prishtinë, 2001, f.89-94.

² Agnja Desnickaja, *Mbi prejardhjen e gjuhës shqipe*, në: revistën “Studime”, nr. 5,6,7, Prishtinë, 2001, f.181-192.

³ Victor A. Fridman, *After 170 years of Balkan linguistics: wither the millennium?*, në: revistën “Studime”, nr. 5,6,7, Prishtinë, 2001, f. 223-237.

⁴ Brain D. Joseph, *Comparative perspectives on the place of Arvanitika within Greece and the greek environment*, në: revistën “Studime”, nr. 5,6,7, Prishtinë, 2001, f.293-300.

⁵ Victor A. Fridman, *A gramar-based approach to competency in Albanian and some remarks on teaching the less commonly taught languages of eastern Europe*, në: revistën “Studime”, nr. 5,6,7, Prishtinë, 2002, f. 11-21.

⁶ Armin Hetzer, *Die schaffung der albanischen nationalssprache*, në: revistën “Studime”, nr. 5,6,7, Prishtinë, 2002, f. 67-99.

⁷ Christain Gut, *Edhe një herë për tekstin e pabotuar shkodran të viteve 1850*, në: revistën “Studime”, nr. 5,6,7, Prishtinë, 2002, f. 339-341.

⁸ Christain Gut, *Pashko Vasa et son evre*, në: revistën “Studime”, nr. 10. Prishtinë, 2003, f.29-33.

⁹ Eric P. Hamp, *Studies in Indo-European *oi, ei*, në: revistën “Studime”, nr. 10. Prishtinë, 2003, f. 57-65.

¹⁰ Basil Schader, *Hulumtime gjuhësore rrëth kos-suiçingut shqip-gjermanisht në Zvicrën gjermanishtfolëse*, në: revistën “Studime”, nr. 11, Prishtinë, 2004, f. 135-154.

¹¹ Franc Kriznar, *Mjetet dhe gjuha shprehëse kompozicionale-teknike në opusin e kompozitorit Zeqirja Ballata*, në: revistën “Studime”, nr. 11, Prishtinë, 2004, f.155-166.

¹² Wilfried Fiedler, *Zgjedhimi i katërt dhe gjuha e Buzukut*, në: revistën “Studime”, nr. 12, Prishtinë, 2005, f. 23-32.

¹³ Kristina Gyt, *Pashko Basa dhe alfabeti*, në: revistën “Studime”, nr. 12, Prishtinë, 2005, f. 61-66.

Në numrin 14 botohet shkrimi i Wilfred Fidlerit², Zum Neutrumb im Albanischen und Baltixchen dhe i Joachim Matzinger.³

Në numrat 16,17 kemi botimin e artikullit të Wilfred Fidlerit⁴, Selman Riza dhe habitorja e shqipes. Po ashtu batohet edhe artikulli i Erik Hamp⁵ Albanian dhë ‘earth’, në të cilin rimerr argumentet e tij të mëhershme lidhur me këtë etimologji duke i vënë në kontekst me etimologji të autorëve të tjera më vonë, kur mund të ketë ndodhur që të tijat të mos jenë shënuar.

Në numrin 18 kemi artikullin e Fridmanit⁶, Politika gjuhësore dhe politika e gjuhës në Ballkanin perëndimor bashkëkohor: paskajoret, turqizmat dhe eurolingustika. Në këtë artikull diskutohen zhvillime të reja në hapësirën gjuhësore ballkanike dhe në fushën e ideologjisë gjuhësore në ndërlidhje me disa ndryshime të vona politike.

Në numrin 20 të kësaj reviste përsëri kemi një shkrim nga Fridmani⁷, Shumësi turk –lv r (-lar/-ler) në gjuhën shqipe dhe në kontekstin ballkanik.

Po në numrin 21 kemi edhe një tjetër shkrim nga Fridmani⁸, Prirjet e ndryshimet morfosintaksore dhe sintaksore në gjuhën shqipe.

Po në këtë numër kemi një artikull nga Levente Nagy⁹, Një studiues hungarez i albanologjisë: Lajos Tamas.

Revista “Gjurmime albanologjike, seria e shkencave filologjike”

Numri i parë i revistës “ *Gjurmime albanologjike- seria e shkencave filologjike*” ka dalë më 1962. Fillimi i Revista ishte pronë e Fakultetit Filozofik, por nga vitit 1967 e deri me sot është pronë e Instituti Albanologjik në Prishtinë. Studiuesit e huaj që kanë botuar në këtë revistë vijnë nga hapësirat e ish-Jugosllavisë, Evropa dhe Amerika, ndër ta mund t’i përmendim: Norbert Jokli, Millan Budimir, Kristian Gut, Wilfried Fiedler, Anna Korytowska, Miljko Jovanovic, Oda Buchholz, Erik Hamp, Agnes Gut, Wielfried Fiedler, Boris Markov, Manuela Spaturu, Agnija V. Desnickaja, Irena Sawicka, Bozhidar Vidoecki, Vaclav Polak, Frenc Jakopin, Gerda Uhlisch, Irena Sawicka.

Norbert Jokli¹⁰, Naim Be Frashëri e pasunimi i gjuhës shqipe

Millan Budimir¹¹, Alb. Zot < diaitas ‘iudex arbitrē retractatur’.

Kristian Gut¹², Kontaktet linguistike midis shqipes e maqedonishtes,

Wilfried Fiedler¹³, Zhvillimi i infinitivit gegë nga aspekti i ballkanologjisë,

¹ Eric P. Hamp, *Vendi i shqipes*, në: revistën “Studime”, nr. 13, Prishtinë, 2006, f.45-69.

² Wilfried Fiedler, *Zum Neutrumb im Albanischen und Baltixchen*, në: revistën “Studime”, nr. 14, Prishtinë, 2007, f.33-49.

³ Joachim Matzinger, në: revistën “Studime”, nr. 14, Prishtinë, 2007, f. 63-73.

⁴ Wilfried Fiedler, *Selman Riza dhe habitorja e shqipes*, në: revistën “Studime”, nr. 116-17, Prishtinë, 2010, f.43-48.

⁵ Eric P. Hamp, *Albanian dhë ‘earth’*, në: revistën “Studime”, nr. 116-17, Prishtinë, 2010, f. 225-230.

⁶ Victor A. Fridman, *Language politics and language policies in the contemporary western Balkans: Infinitives, turkisms and eurolinguistics*, në: revistën “Studime”, nr. 18, Prishtinë, 2011, f.175- 185.

⁷ Victor A. Fridman, *Shumësi turk –lv r (-lar/-ler) në gjuhën shqipe dhe në kontekstin ballkanik*, në: revistën “Studime”, nr. 20, Prishtinë, 2013, f. 35-47.

⁸ Victor A. Fridman, *Prirjet e ndryshimet morfosintaksore dhe sintaksore në gjuhën shqipe*, në: revistën “Studime”, nr. 21, Prishtinë, 2014, f. 239-249.

⁹ Levente Nagy, *Un studioso ungherese di albanologia: Lojas Tamas*, në: revistën “Studime”, nr. 21, Prishtinë, 2014, 249-262.

¹⁰ Norbert Jokli, *Naim Be Frashëri e pasurimi i gjuhës shqipe*, në: revistën Gjurmime Albalogjike, Seria e shkencave filologjike, Nr. 2, Prishtinë, 1972, f. 21-32.

¹¹ Millan Budimir, *Alb. Zot < diaitas ‘iudex arbitrē retractatur’*, në: revistën Gjurmime Albalogjike, Seria e shkencave filologjike, Nr. 2, Prishtinë, 1972, f. 85-86.

¹² Kristian Gut, *Kontaktet linguistike midis shqipes e maqedonishtes*, në: revistën Gjurmime Albalogjike, Seria e shkencave filologjike, nr. 3, Prishtinë, 1973, f. 51-56.

¹³ Wilfried Fiedler, *Zhvillimi i infinitivit gegë nga aspekti i ballkanologjisë*, në: revistën Gjurmime Albalogjike, Seria e shkencave filologjike, nr. 5, Prishtinë, 1976, f. 27-46.

Anna Korytowska¹, Sandhi në gjuhën shqipe në Kosovë.

Nobert Jokli², Historia e shqipes e dokumentet e saja

Miljko Jovanovic³, Henrik Bariçi si përbledhës i opusit krijues të Ivo Qipikos.

Antonino Guzzeta⁴, Për një deskriptim funksional të morfolologjisë së substantivit në të folmet e Arbëreshve të Konstesa Entelinës.

Oda Buchholz⁵, Për rolin e Eqrem Çabejt në fushën e ballkanistikës.

Erik Hamp⁶, Studime rreth o-së në gjuhën shqipe

Oda Buchholz, Wilfried Fiedler⁷, Rreth zhvillimit të disa termave politiko-shoqërorë në gjuhën shqipe,

Agnes Gut⁸, Rreth teorisë së togfjalëshit në gjuhën shqipe,

Wielfried Fiedler⁹, Struktura e kategorisë së kohës në gjuhët e Ballkanit,

Boris Markov¹⁰, Disa vërejtje për prapashtesën –ishtë (-ishte) në gjuhën shqipe dhe në gjuhët sllave,

Manuela Spaturu¹¹, Rendi i fjalëve në fjali,

Wilfried Fiedler¹², Për çështjen e shënimit të kuantitetit të zanoreve në gjuhën e Buzukut.

Agnija V. Desnickaja¹³, Disa vërejtje dhe mendime rreth çështjes së kuptimit të kategorisë së admirativit në shqipe.

Oda Buchholc¹⁴, Rreth tautologjisë së shprehjen e determinativitetit

Boris Markov¹⁵, Emra mocioni në gjuhën shqipe

Irena Sawicka¹⁶, Edhe një herë për grupet e bashkëtingëlloreve të tipit nazal + okluzive në gjuhën shqipe.

Agnia V. Desnickaja¹⁷, Disa mendime rreth problemeve linguistike të Kanunit

¹ Anna Korytowska, *Sandhi në gjuhën shqipe në Kosovë*, në: revistën Gjurmime Albanologjike, Seria e shkencave filologjike, Nr. 40, Prishtinë, 2011, f. 57-64.

² Nobert Jokli, *Historia e shqipes e dokumentet e saja*, në: revistën Gjurmime Albanologjike, Seria e shkencave filologjike, nr. 30-31, Prishtinë, 2000-2001, f. 11-16.

³ Miljko Jovanovic, *Henrik Bariçi si përbledhës i opusit krijues të Ivo Qipikos*, në: revistën Gjurmime Albanologjike, Seria e shkencave filologjike, nr. 18, Prishtinë, 1989, f. 81-87.

⁴ Antonino Guzzeta, *Për një deskriptim funksional të morfolologjisë së substantivit në të folmet e Arbëreshve të Konstesa Entelinës*, në: revistën Gjurmime Albanologjike, Seria e shkencave filologjike, nr. 18, Prishtinë, 1989, f. 9-29.

⁵ Oda Buchholz, *Për rolin e Eqrem Çabejt në fushën e ballkanistikës*, në: revistën Gjurmime Albanologjike, Seria e shkencave filologjike, nr. 17, Prishtinë, 1987, f. 33-38.

⁶ Erik Hamp, *Studime rreth o-së në gjuhën shqipe*, në: revistën Gjurmime Albanologjike, Seria e shkencave filologjike, nr. 6, Prishtinë, 1978, f.41-46.

⁷ Oda Buchholz, Wilfried Fiedler, *Rreth zhvillimit të disa termave politiko-shoqërorë në gjuhën shqipe*, në: revistën Gjurmime Albanologjike, Seria e shkencave filologjike, nr. 10, Prishtinë, 1980, f. 55-74.

⁸ Agnes Gut, *Rreth teorisë së togfjalëshit në gjuhën shqipe*, në: revistën Gjurmime Albanologjike, Seria e shkencave filologjike, nr. 10, Prishtinë, 1980, f. 185-188.

⁹ Wielfried Fiedler, *Struktura e kategorisë së kohës në gjuhët e Ballkanit*, në: revistën Gjurmime Albanologjike, Seria e shkencave filologjike, nr. 14, Prishtinë, 1985, f. 45-65.

¹⁰ Boris Markov, *Disa vërejtje për prapashtesën –ishtë (-ishte) në gjuhën shqipe dhe në gjuhët sllave*, në: revistën Gjurmime Albanologjike, Seria e shkencave filologjike, nr. 14, Prishtinë, 1985, f. 229-237

¹¹ Manuela Spaturu, *Rendi i fjalëve në fjali*, në: revistën Gjurmime Albanologjike, Seria e shkencave filologjike, nr. 15, Prishtinë, 1986, f. 89-103.

¹² Wilfried Fiedler, *Për çështjen e shënimit të kuantitetit të zanoreve në gjuhën e Buzukut*, në: revistën Gjurmime Albanologjike, Seria e shkencave filologjike, nr. 16, Prishtinë, 1986, f. 41-54.

¹³ Agnija V. Desnickaja, *Disa vërejtje dhe mendime rreth çështjes së kuptimit të kategorisë së admirativit në shqipe*, në: revistën Gjurmime Albanologjike, Seria e shkencave filologjike, nr. 16, Prishtinë, 1986, f. 69-79.

¹⁴ Oda Buchholc, *Rreth tautologjisë së shprehjen e determinativitetit*, në: revistën Gjurmime Albanologjike, Seria e shkencave filologjike, nr. 16, Prishtinë, 1986, f. 151-165.

¹⁵ Boris Markov, *Emra mocioni në gjuhën shqipe*, në: revistën Gjurmime Albanologjike, Seria e shkencave filologjike, nr. 16, Prishtinë, 1986, f.237-248.

¹⁶ Irena Sawicka, *Edhe një herë për grupet e bashkëtingëlloreve të tipit nazal + okluzive në gjuhën shqipe*, në: revistën Gjurmime Albanologjike, Seria e shkencave filologjike, nr. 13, Prishtinë, 1984, f. 79-91.

¹⁷ Agnja V. Desnickaja, *Disa mendime rreth problemeve linguistike të Kanunit*, në: revistën Gjurmime Albanologjike, Seria e shkencave filologjike, nr. 11, Prishtinë, 1982, f. 57-63.

Agnia V. Desnickaja¹, Çështja e koinesë së Veriut në kuadrin e përgjithshëm të historisë së gjuhës shqipe
Erik P. Hamp², Fjala javë, reduktimi i saj fonetik dhe sintaksa
Bozhidar Vidoeski³, Formimi i dialekteve të maqedonishtes
Haralambie Mihaescu⁴, Remarques sur les rapports lexicaux albano-aroumains
Vaclav Polak⁵, Specimen du distionnaire etymologique de la langa Albanaise,
Oda Buchholz⁶, Mbi gegërishten e aspekteve morfologjike e sintaksore tek rasat në gjuhën shqipe
Wilfried Fiedler⁷, Supletivizmi në sistemin foljor të gjuhës së Buzukut,
Frenc Jakopin⁸, Kontributi i Rajko Nahtigalit shkencës së albanologjisë,
Olivera Jashari- Nasteva, Bozhidar Vidoeski, Bllazhe Koneski⁹, Kontaktet e të folmeve maqedonase me
të folmet shqipe.
Gerda Uhlisch¹⁰, Studime mbi përcaktorët emërorë të gjuhës së sotme shqipe
Erik Hamp¹¹, Marrëdhënet gjuhësore maqedonase-shqiptare
Irena Sawicka¹², Struktura e rrokjes së shqipes kosovare,
Kamila Liberacka¹³, Redupliakcioni i kundrinorit në gjuhën shqipe

Përfundime

Mund të themi se në kuadër të këtyre revistave shkencore, studiuesve të huaj u është dhënë hapësirë e mjaftueshme për t'i prezantuar rezultatet e studimeve të tyre në fushë të gjuhës. Në revistën “Gjurmime albanologjike- seria e shkencave filologjike” vërehet një interesim më i madh i autorëve nga hapësira e ish-Jugosllavisë dhe e Rusisë, ndërsa në revistën shkencore “Studime” që është shumë më e vonshme se revista “Gjurmime albanologjike”, vërehet një prezencë më e madhe e autorëve nga Evropa dhe Amerika. Fushat që trajtohen nga këta autorë janë të ndryshme, duke filluar nga historia e shqipes, dialektet e saj, kontaktet e saj me gjuhën e tjera, çështje të morfologjisë e sintaksës etj. Kontributi i këtyre autorëve është jashtëzakonisht i rëndësishëm për shqipen, gjë që tregon se kjo fushë ka qenë në vazhdimësi në planet e tyre studimore.

¹ Agnia V. Desnickaja, *Çështja e koinesë së Veriut në kuadrin e përgjithshëm të historisë së gjuhës shqipe*, në: revistën Gjurmime Albanologjike, Seria e shkencave filologjike, nr. 8, Prishtinë, 1979, f. 95-110.

² Erik P. Hamp, *Fjala javë, reduktimi i saj fonetik dhe sintaksa*, në: revistën Gjurmime Albanologjike, Seria e shkencave filologjike, nr. 8, Prishtinë, 1979, f. 121-130.

³ Bozhidar Vidoeski, *Formimi i dialekteve të maqedonishtes*, në: revistën Gjurmime Albanologjike, Seria e shkencave filologjike, nr. 8, Prishtinë, 1979, f.131-136.

⁴ Haralambie Mihaescu, *Remarques sur les rapports lexicaux albano-aroumains*, në: revistën Gjurmime Albanologjike, Seria e shkencave filologjike, nr.7, Prishtinë, 1978, f. 117-124.

⁵ Vaclav Polak, *Specimen du distionnaire etymologique de la langa Albanaise*, në: revistën Gjurmime Albanologjike, Seria e shkencave filologjike, nr.7, Prishtinë, 1978, f. 125-142.

⁶ Oda Buchholz, *Mbi gegërishten e aspekteve morfologjike e sintaksore tek rasat në gjuhën shqipe*, në: revistën Gjurmime Albanologjike, Seria e shkencave filologjike, nr.7, Prishtinë, 1978, f. 143-156.

⁷ Wilfried Fiedler, *Supletivizmi në sistemin foljor të gjuhës së Buzukut*, në: revistën Gjurmime Albanologjike, Seria e shkencave filologjike, nr.7, Prishtinë, 1978, f. 157-180.

⁸ Frenc Jakopin, *Kontributi i Rajko Nahtigalit shkencës së albanologjisë*, në: revistën Gjurmime Albanologjike, Seria e shkencave filologjike, nr.7, Prishtinë, 1978, f. 207-218.

⁹ Olivera Jashari- Nasteva, Bozhidar Vidoeski, Bllazhe Koneski, *Kontaktet e të folmeve maqedonase me të folmet shqipe*, në: revistën Gjurmime Albanologjike, Seria e shkencave filologjike, nr.19, Prishtinë, 1989, f. 55-63.

¹⁰ Gerda Uhlisch, *Studime mbi përcaktorët emërorë të gjuhës së sotme shqipe*, në: revistën Gjurmime Albanologjike, Seria e shkencave filologjike, nr. 19, Prishtinë, 1989, f. 87-116.

¹¹ Erik Hamp, *Marrëdhënet gjuhësore maqedonase-shqiptare*, në: revistën Gjurmime Albanologjike, Seria e shkencave filologjike, nr. 36, Prishtinë, 2006, f. 99-102.

¹² Irena Sawicka, *Struktura e rrokjes së shqipes kosovare*, në: revistën Gjurmime Albanologjike, Seria e shkencave filologjike, nr.37, Prishtinë, 2007, f. 55-62.

¹³ Kamila Liberacka, *Redupliakcioni i kundrinorit në gjuhën shqipe*, në: revistën Gjurmime Albanologjike, Seria e shkencave filologjike, nr. 38, Prishtinë, 2008, f. 143-150.